



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr.382 Prot

Tiranë, më 17/02/2023

REKOMANDIM

Nr.05, datë 17/02/2023

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS”

Në mbështetje të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://ust.edu.al/>, të Autoritetit Publik/Universiteti i Sporteve të Tiranës (në vijim “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim “LDI”), kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Në zbatim të gjurmës “c”, pika 2 e nenit 4, nenit 5 dhe 6 të LDI, Zyra e Komisionerit ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik.

Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Nisur nga rëndësia që paraqet sektori i arsimit të lartë, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës për vitin 2023, monitorimin e transparencës proaktive në të gjithë universitetet publike të vendit.

Përpos parashikimeve në LDI, transparenca e institucioneve të arsimit të lartë ushtrohet edhe në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për arsimin e lartë, veçanërisht në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin nr.781, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë hapa për monitorimin e transparencës proaktive në këtë sektor, duke shtrirë monitorimin në të gjithë universitetet publike të vendit.

Nga monitorimi i kryer në menunë e faqes zyrtare <https://ust.edu.al/>, në ikonën “Rreth nesh”, Autoriteti Publik ka publikuar “Programin e Transparencës”, ku është konstatuar se është publikuar pjesërisht informacion, ose informacioni i publikuar është i papërditësuar, ose një pjesë e tij është publikuar në faqen zyrtare të universitetit duke mos e përfshirë në programin e transparencës. Specifikisht, është publikuar informacion rreth autoritetit, si organigrama, struktura dhe kategoritë e pagave (përfshirë rektoratin dhe administratorin), e drejta për t’u informuar, ku janë vendosur të dhënat e koordinatorit e të drejtës për informim, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.

Bazuar në monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit konstaton mosvënien në zbatim të tij, në përputhje me pikën 1 të nenit 7, të LDI, si dhe Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar të Komisionerit, konkretisht në rubrikat e mëposhtme:

Rreth autoritetit:

- numrin e punonjësve të institucionit të arsimit të lartë (përfshirë rektoratin, strukturën e administratorit dhe fakultetet)
- strukturat e tjera të organeve kolegjiale akademike si: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Asambleja e Personelit Akademik, Komisionet e Përhershme, Këshilli i Etikës së Rektoratit, qendra kërkimore shkencore, qendra studimore ndërdisiplinore, strukturat shëndetësore universitare, etj.;
- funksionet, dhe detyrat e institucionit publik të arsimit të lartë, si dhe njësisive përbërëse të tij (bazuar në ligjin 80/2015)

- cv-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi (Rektori, Administratori dhe Dekanët e fakulteteve) si dhe përshkrimi i procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre.
- cv e pedagogëve dhe rezultatet e kontrollit të verifikimit të titujve shkencor (bazuar edhe në vendimin nr.781/2018, të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);
- procedura/mekanizma për bërjen e ankesave dhe kërkesave në lidhje me mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të arsimit të lartë (përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve);

Legjislacioni:

- legjislacioni ndërkombëtar.
 - konventa;
- akte ligjore dhe nënligjore.
 - ligje, statuti, rregullore e funksionimit të universitetit, rregullore e funksionimit të Rektoratit, rregullore e funksionimit dhe organizimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, rregullore e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese akademike në universitete, rregullore e konfliktit të interesit, rregullore për organizimin e zgjedhjeve për Këshillat Studentore, rregullore e organizimit të programeve të studimit, vendimet e Senatit Akademik, vendimet e Bordit të Administrimit, vendimet e rektoratit, vendimet e Këshillit të Etikës, urdhrat e Rektorit, etj.,
- aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit (nëse ka);
 - strategjia e zhvillimit institucional;
- raport vjetor i veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë;
- manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun;
- akte të tjera si psh: marrëveshjet dy ose shumë palëshe në nivel të institucioneve të arsimit të lartë apo institucione të tjera (bazuar edhe në vendimin nr 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi institucionin e arsimit të lartë:

- planet strategjike të punës;
- raporte monitorimi/auditimi (p.sh: raporte auditimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.);
- dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës të institucionit të arsimit të lartë.

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të institucionit të arsimit të lartë:

- buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara përfshirë të dhëna për buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti vjetor, dhe të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale

për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (bazuar edhe në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);

- raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset;
- donacione, sponsorizime dhe kontratat grantesh (sipas viteve);
- dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve në ato raste kur institucioni i arsimit të lartë vetëfinancohet nga çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, (psh bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga tarifat e studentëve, pagesat e detyrimeve të prapambetura të universitetit, etj.).

Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat të institucionit të arsimit të lartë:

- lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve);
- regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;
- regjistri i realizimeve të prokurimit publik;
- informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme (bazuar edhe në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);

Shërbimet që ofron institucioni i arsimit të lartë:

- kuotat e parashikuara për çdo vit akademik;
- instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor;
- instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse dhe kriteret (bursa publike dhe ato specifike);
- informacion mbi programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve;
- kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve;
- publikimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- kopje dokumentacioni, vërtetime, etj, përfshirë informacioni për tarifat përkatëse (nëse ka), procedura dhe formular aplikimi, afati kohor, procedurë ankimimi, standardet për cilësinë e shërbimit

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë:

- procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me ushtrimin e funksioneve të AP, mekanizmat dhe procedurat për bërjen e ankesave dhe kërkesave në lidhje me mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të arsimit të lartë, procedurën nëpërmjet të cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimit të funksioneve të arsimit të lartë; (bazuar edhe në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);

Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga institucionet e arsimit të lartë:

- procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet;
- procedura e ankimimit;

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga institucionet e arsimit të lartë:

- njoftime të ndryshme;
- njoftime për procedurat e rekrutimit;
- publikime;
- statistika;
- projekte;
- bashkëpunime etj.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet informacionit sipas Programit të Transparencës të Rishikuar miratuar me Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi, si dhe legjislacionit në fuqi të arsimit të lartë.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritet është i detyruar ligjërisht t'a zbatojë atë.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të përditësojë, ndërlihdë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, "Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas

mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre”, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 ditë nga momenti i marrjes dijeni.

3. Në zbatim të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin administrativ.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17.02.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/ Universiteti i Sporteve të Tiranës.

Shkurt 2023

Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”.

	Rreth autoritetit	
	Struktura, organigramave përfshirë numrin e punonjësve dhe kategoritë e pagave e Rektoratit	Po
	Struktura, organigramave përfshirë numrin e punonjësve dhe kategoritë e pagave Struktura e Administratorit	Po
	Struktura, organigramave përfshirë numrin e punonjësve dhe kategoritë e pagave Struktura e Fakulteteve	Jo
	Struktura e organeve kolegjinale akademike si Senati Akademik; Asambleja e Personelit Akademik; Komisionet e përhershme; Këshilli i Etikës së Rektoratit si dhe njësi të tjera si: Qendra kërkimore shkencore, Qendrat studimore ndërdisiplinore, Strukturat shëndetësore universitare;	Jo
	Funksionet, dhe detyrat e institucionit publik të arsimit të lartë si dhe njësive përbërëse të tij (bazuar në ligjin 80/2015)	Jo
	CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi (Rektori Administratori dhe Dekanëve) si dhe përshkrim i procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre.	Jo
	Cv e pedagogëve dhe rezultatet e kontrollit të verifikimit të titujve shkencor (bazuar në VKM	Po për Cv e pedagogëve , por nuk i ndërlidh në PT

	781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);	
	Procedura/mekanizma bërjen e ankesave dhe kërkesave në lidhje me mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të arsimit të lartë (përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve);	Jo
2	Legjislacion:	
2.1	<u>Legjislacion ndërkombëtar</u>	
	Konventa, marrëveshje ndërkombëtare;	Jo
2.2	<u>Legjislacion kombëtar</u>	
	Ligji për arsimin e lartë, si dhe ligje të tjera që zbatohen në veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë	Jo
2.3	Akte nënligjore	
	Statuti	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Rregullorja e Universitetit	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Rregullorja e Rektoratit	Jo
	Rregullore e funksionimit dhe organizimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Rregullore e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese akademike në universitete.	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Rregullore e konfliktit të interesit	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për Këshillat Studentore	Jo
	Rregullorja e organizimit të programeve të studimit	Jo
	Vendimet e Senatit Akademik	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Vendimet e Bordit të Administrimit	Po, por nuk e ndërlihdh në PT

	Vendimet e Rektoratit	Jo
	Vendimet e Këshillit të Etikës	Jo
	Urdhrat e Rektorit	Jo
2.4	Kodi i sjelljes	Jo
2.5	Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit (nëse ka)	Jo
2.6	Strategji (Strategjia e Zhvillimit Institucional)	Jo
2.7	Raport vjetor i veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
2.8	Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e institucionet e arsimit të lartë dhe që prek publikun	Jo
	Akte të tjera si psh: Marrëveshjet dy ose shumë palëshe në nivel të institucioneve të arsimit të lartë apo institucione të tjera (bazuar në VKM 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë)	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
3	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar	
	Koordinatori	Po
	E-mail	Po
	Nr. i gjelbër/ Tel	Jo
	Adresa	Po
	Orari	Po
	Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)	Po
	Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)	Po
4	Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi institucionin e arsimit të lartë	

	Planet strategjike të punës	Jo
	Raporte monitorimi/auditimi (p.sh: raporte auditimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, KLSH, etj.)	Jo
	Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së tw institucioneve tw arsimit tw lartw	Jo
5	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të institucionit të arsimit të lartë	
	Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara <i>përfshirë të dhëna për buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti vjetor, dhe të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara</i> (bazuar edhe në VKM 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë),	Jo
	Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset	Jo
	Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve <i>në ato raste kur institucioni i arsimit të lartë vetëfinancohet nga çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, (psh bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga tarifat e studentëve, pagesat e detyrimeve të prapambetura të universitetit, etj.)</i>	Jo
6	Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat të institucionit të arsimit të lartë;	
	Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)	Jo
	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik	Jo
	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik	Jo

	Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme (bazuar edhe në VKM 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);	Jo
7	Shërbimet që ofron institucioni i arsimit të lartë; Lista e shërbimeve e listuar: Përfshirë informacioni për tarifrat përkatëse (nëse ka), procedura dhe formular aplikimi, afati kohor, procedurë ankimimi, standardet për cilësinë e shërbimit	Jo
	Kuotat e parashikuara për çdo vit akademik	Vetëm për vitin aktual, por nuk e ndërlihdh në PT
	Instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse dhe kriteret (bursa publike dhe ato specifike),	Jo
	Informacion mbi programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve	Jo
	Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve	Pjesërisht, por nuk e ndërlihdh në PT
	Publikimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore	Po, por nuk e ndërlihdh në PT
	Kopje dokumentacioni, vërtetime, etj.	Jo
8	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.	
	Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me ushtrimin e funksioneve të institucioneve të arsimit të lartë, mekanizmat dhe procedurat për bërjen e ankesave dhe kërkesave në lidhje me mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të arsimit të lartë, procedurën nëpërmjet të cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre në hartimin e ligjeve, të	Jo

	politikave publike apo ushtrimit të funksioneve të arsimit të lartë; (bazuar edhe në VKM 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë);	
9	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve	
	Lista e dokumenteve që administrohen nga institucioni i arsimit të lartë me afatet e ruajtjes	Jo
	Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)	Jo
10	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve	
	Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)	Po
11	Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga institucionet e arsimit të lartë.	
	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga institucionet e arsimit të lartë.	Jo
	Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve sipas kategorive të përcaktuara në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondii mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” të ndryshuar;	Jo
	Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim	Jo
	Procedura e ankimimit	Jo
12	Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga institucionet e arsimit të lartë	
	Njoftime të ndryshme	Po, por nuk i ndërlidh në PT
	Njoftime për procedurat e rekrutimit	Po, por nuk i ndërlidh në PT
	Publikime	Jo

	Statistika	Jo
	Projekte	Po, por nuk i ndërlidh në PT
	Bashkëpunime etj.	Po, por nuk i ndërlidh në PT